



Perspektiva juaj  
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve



## Raport Muaji Janar 2024

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit  
Monedha  
Datë Lancimi  
Datë e mbarimit te Ofertes  
Fillestare  
Vlera fillestare e kuotës  
Shuma fillestare minimale  
Shuma minimale pasuese

**Raiffeisen Invest sh.a**

**LEK**

**20 Gusht 2018**  
**03 Shtator 2018**

**1,000**

**30,000**

**10,000**

### Objktivi i investimit dhe profili i investitorit

Objktivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjafsheshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emtuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsy, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

### Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje  
Tarifë në dalje  
Tarifë Administrimi në vit  
  
Tarifa te tjera te vazhdueshme  
  
Komisione/tarifa e vazhdueshme  
  
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta

**0%**  
**2% (cdo shlyerje para 2 viteve)**  
**Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve**

**Referojuni prospektit te fondit**

**1.28% per vitin 2023**

**Referojuni informacionit ne deget e RBAL**

Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2023. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund te kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

### Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë  
Përfitimet tipike më të larta

1

2

**3**

4

5

6

7


Profil i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënët historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risc. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës se fondit. Të dhënët historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

### Të dhëna për Fondin në 31.01.2024

<b>Vlera Neto e Aseteve</b>	<b>8,733,197,153</b>
<b>Numri i investitoreve</b>	<b>3,576</b>
<b>Cmimi i Kuotes</b>	<b>1,153.4316</b>
<b>*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.01.2023 – 31.01.2024)</b>	<b>10.71%</b>

\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera te vazhdueshme zbriten përparrë llogaritjes së kthimit nga investimi

### Struktura e portofolit te investimeve ne 31 Janar 2024



Ne kuader te politikes se investimit te fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht ne obligacione thesari, te emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, permes pjesemarrjes ne ankandet e tregut primar dhe transaksioneve ne tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon qe te pakten 50 – 80 % e aseteve te fondit te investohen ne obligacione afatgjate te Qeverise se Republikes se Shqiperise. Fondi mban një pjese te aseteve ne depozita afatshkurtra per te plotesuar ne çdo kohe nevojat per likuiditet te investitoreve. Vlera neto e aseteve te fondit eshte ne nivelin e LEK 8.7 miliarde ne date 31 Janar 2024.

Instrumenti	Ne % te Aseteve te Fondit
Obligacione Thesari	86.71%
Bono Thesari	1.67%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	11.62%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here ne muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me te rralla, afersisht një here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here ne 2 muaj per secilin maturitet.

## Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Janar


Ne Janar norma bazë e interesit eshte e pandryshuar në nivelin 3.25%. Norma e fundit e publikuar per inflacionin ne muajin Dhjetor ishte 4.00%.

Asetet e Fondit Vizion jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve.

Normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare kane ndjekur nje trend miks per gjate muajit Janar, por pa ndryshime te mëdha. Keshtu yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 4.21%, duke rene me 0.02% krahasuar me ankandin paraardhes dhe Yield i obligacionit reference 5-vjeçar rezultoi ne 5.623%, duke rene me 0.03% krahasuar me ankandin e fundit.

Ndersa yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 3.621%, duke u rritur me 0.26% krahasuar me ankandin e muajit Dhjetor dhe yield i obligacionit 10 vjeçar rezultoi ne 6.78%, duke u rritur me 0.34% krahasuar me ankandin paraardhes.

Grafiket me poshte jepin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Janar 2023 – Janar 2024. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fiksë te perllogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Janar.



## Performance e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Janar 2024


Kthimi neto me baze vjetore, per periudhen 31 Janar 2023 – 31 Janar 2024 eshte **10.71%**.

Çmimi i kuotes se fondit Vizion eshte rritur me **+0.42%** gjate muajit Janar.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic Jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare.


Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.

### Ecuria e çmimit te kuotes Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 31 Janar 2024	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	<b>10.71%</b>	1.11%	2.30%	2.33%	2.67%

### Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon një periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbuges se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i një tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumt kohor te qendrimi ne fond, Investitorët e fondit Vizion dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene një horizont sa me te gjate investimi per te perfituar një kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fordin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci per kthimin ne ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdonur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdonur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojne një kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrate të Raiffeisen Invest sha., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.